



GAZIDEDE
CUSTOMS & EXCISE CONSULTING

Model kundërshtimi ndaj auditeve të KLSH lidhur me aplikimin e Taksës së Ambalazheve Plastike (TAM) për importet e mëparshme

Tiranë, 11 Nëntor 2019

Besar Gazidede | Konsulent Doganor & Akcize
Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize
Rruga Sulejman Delvina, Sheshi Wilson, 1/1, Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 69 405 0005, Email: info@gazidede.al, Web: <https://gazidede.al>
NUIS L82301001A

Ref. GCEC/4/TAM/11112019



Me fillimin e muajit nëntor është bërë "traditë" që fillon edhe periudha e përfundimit të program kontrolleve apo auditeve të KLSH pranë administratës doganore.

Shpesh, këto program kontrolle apo audite identifikojnë lista të tëra me Kompani, përmbajnë përfundime për shkelje dhe rekomandime për të aplikuar detyrime doganore shtesë etj. lidhur me deklarata doganore të periudhave të mëparshme.

Gjithashtu, sipas "traditës", pa shqyrtuar ligjshmërinë e përfundimeve të program kontrolleve apo auditeve të KLSH, autoritetet doganore thërrasin përfaqësuesit e Kompanive të identifikuara "për t'u njohur me materialin" apo "për të dhënë shpjegime".

Nga eksperiencia, një pjesë e përfundimeve të program kontrolleve apo auditeve të KLSH lidhen me taksën e ambalazheve plastike (TAM).

Në këto program kontrolle apo audite mund të pretendohet se një artikull i importuar (p.sh. film për ambalazh, fletë për ambalazh, shirit ngjitës për ambalazh etj. klasifikuar në krerët tariforë 3917, 3919, 3920 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave) do duhej të ishte taksuar me TAM në nivelin 100 lekë/kg, ndonëse artikulli i importuar nuk klasifikohet në kreun tarifor 3923 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Sigurisht një pretendim i tillë do të ishte tërësisht i pabazuar dhe në kundërshtim me legjislacionin. Duke iu referuar versioneve në fuqi para datës 1 Janar 2019 të Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare" dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26 datë 04.09.2008 "Për Taksat Kombëtare", është e qartë se aplikimi i taksës së ambalazheve plastike (TAM) legjitimohet vetëm për ambalazhet plastike që klasifikohen në kreun tarifor 3923 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave ose kur materiali plastik zë të paktën 51% të masës së përgjithshme të produkteve që ambalazhon.

Për të ardhur në ndihmë të Kompanive që mund të përballen me një përfundim të tillë të pabazuar, bashkëngjitur këtij materiali kemi vendosur 2 modele shkresore:

1. Një model shkresor me objekt **"Kërkesë për të marrë një fotokopje të çdo dokumenti pjesë e dosjes lidhur me program kontrollin"** e cila ka si qëllim marrjen në formë shkresore të çdo materiali të autoriteteve doganore dhe KLSH lidhur me përfundimet e arritura.

E drejta e palëve për t'u njohur me dosjen dhe për të marrë kopje të çdo dokumenti që ndodhet në dosje mbështetet mbi Nenin 45 të Ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", dhe autoritetet doganore janë të detyruar të japin fotokopje të dokumenteve të kërkuara brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Mosrespektimi i kësaj të drejte përbën pengesë për ushtrimin e të drejtave të palës, dhe përbën shkelje procedurale e cila në varësi të ecurisë së mëtejshme të procedurës mund të sjellë si pasojë paligjshmërinë e aktit administrativ të nxjerrë.



Rekomandojmë që një kërkesë sipas modelit shkresor bashkëngjitur të depozitohet pranë protokollit të zyrës doganore, në momentin kur një përfaqësues i Kompanisë paraqitet pranë autoriteteve për t'u njohur me materialet e dosjes.

2. Një model shkresor me objekt "***Kthim përgjigje***" e cila përmban argumentet e nevojshme ligjore për prapsimin e një pretendimi të pabazuar për të aplikuar TAM për ambalazhet plastike të importuara që nuk klasifikohen në kreun tarifor 3923 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Ky model shkresor është i plotësuar në këndvështrimin e bazës ligjore dhe mjafton të plotësohet me informacionin specifik që shkresa e autoriteteve doganore dhe dokumentet e dosjes përmbajnë.

Në jemi të opinionit se ndjekja e procedurës së mësipërme është tërësisht e mjaftueshme për të prapsuar pretendimet e pabazuara për të aplikuar TAM për ambalazhet plastike të importuara që nuk klasifikohen në kreun tarifor 3923 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Kujdes!

1. **Modelet shkresore bashkëngjitur janë të papërfunduara dhe nevojitet të plotësohen me informacion specifik sipas rastit.**
2. **I gjithë teksti me ngjyrë jeshile është plotësuar me të dhëna fiktive dhe nevojitet të zëvendësohet me informacion specifik sipas rastit.**
3. **Këto modele shkresore nuk përbëjnë këshillë specifike profesionale por kanë si synim dhënien e orientimit të përgjithshëm për Kompanitë që planifikojnë t'i ndjekin vetë procedurat e kundërshtimit për raste të ngjashme.**



Nr. EX1 Prot.

Datë 11.11.2019

Shoqëria: **Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize sh.p.k.**, me NUIS L8XXXXXX1A, me administrator z. Besar Gazidede dhe seli Rruga S. Delvina, Sheshi Wilson 1/1, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 69 40 50 005, Email: info@gazidede.al.

Drejtuar: **Degës së Doganës Tiranë**
Muçaj, Vorë
Tiranë, Shqipëri

Objekti: **Kërkesë për të marrë një fotokopje të çdo dokumenti pjesë e dosjes lidhur me program kontrollin nr. 1001 prot. datë 01.10.2019**

Baza ligjore: Neni 45, Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" (referuar në vijim si "Kodi i Procedurave Administrative")

Të nderuar,

Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize sh.p.k. (referuar në vijim si "Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize" apo "Shoqëria"), regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë Tatimore Tiranë me NUIS L8XXXXXX1A, ka si objekt të aktivitetit konsulencën në fushën doganore dhe të akcizës.

Me datë 10.11.2019, me shkresën tuaj nr. 999 prot. datë 08.10.2019, Shoqëria u njoftua për t'u njohur me program kontrollin nr. 1001 prot. datë 01.10.2019.

Për qëllime të përgatitjes së materialit shkresor lidhur me përfundimet e program kontrollit nr. 1001 prot. datë 01.10.2019, Shoqëria kërkon t'i vendosen në dispozicion fotokopjet e çdo dokumenti pjesë e dosjes lidhur me program kontrollin.

Këtë kërkesë e mbështesim mbi Kodin e Procedurave Administrative Neni 45 i cili parashikon shprehimisht se:

"Neni 45
E drejta e palëve për njohje me dosjen

1. Të gjitha palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrin kopje të tyre.

2. Organi publik, i përfshirë në procedurën administrative, brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës, siguron në mjediset e tij të punës kushte për mbajtjen e të dhënave, si dhe kushte për njohjen dhe marrjen e kopjeve të dokumenteve, sipas pikës 1 të këtij neni.[...]"



Duke iu referuar Nenit 45 të sipërcituar, Komentari i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë nga Sigma (Tiranë, 2018) parashikon shprehimisht se:

- "[...] "marrja e kopjeve" nënkupton mundësinë e marrjes nga ana e palës e riprodhimeve të dokumenteve në dosje. Riprodhimi mund të merret në çfarëdo forme dhe formati, mund jetë një fotokopje e thjeshtë" (Komentari, faqe 194 paragrafi i dytë);
- "Dispozita i referohet palëve në procedurë administrative. Kjo do të thotë që e drejta e njohjes me dosjen të ushtrohet në kuadër të një procesi të filluar tashmë që është në zhvillim e sipër. [...] Përveç kësaj, duhet të theksohet se një e drejtë e tillë mund të ushtrohet edhe pas përfundimit të procedurës administrative (në shkallë të parë) në bazë të nenit 90, mund të ushtrohet edhe para, gjatë ose edhe pas mjeteve ligjore administrative për të bërë të mundur që pala të përgatitet siç duhet për të ushtruar të drejtën e saj për mjetet ligjore (qoftë administrative apo gjyqësore) duke parë dokumentet e dosjes në të cilën organi publik është mbështetur për vendimin e ankimuar" (Komentari, faqe 195 paragrafi i parë);
- "[...] për sa i takon origjinës së dokumenteve, dispozita duhet të lexohet në mënyrë të gjerë duke iu referuar të gjitha llojeve të dokumenteve, qoftë të krijuara nga organi publik që zhvillon procedurën (akte procedurale, shënime, procesverbale, shënime të bëra në dosje ose procesverbalet e mjetura nga organi publik gjatë kryerjes së veprimeve procedurale), qoftë nga organet e tjera publike (nëse është rasti) [...]" (Komentari, faqe 196 paragrafi i parë).

Bazuar në sa më sipër, duke qenë se Kodi i Procedurave Administrative Neni 45 pika 2 parashikon një afat strikt 5 ditor për marrjen e fotokopjeve, ju lutemi që kërkesa jonë të plotësohet jo më vonë se data **16.11.2019**.

Bashkëngjitur ju lutem gjeni:

1. Shkresën tuaj nr. **999** prot. datë **08.10.2019**,
2. **Dokumentin postar të marrjes së njoftimit.**

Ju falënderojmë dhe ju urojmë punë të mbarë.

Me respekt,

Besar Gazidede
Administrator
Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize sh.p.k.
[Vula, firma]



Nr. EX2 Prot.

Datë 20.11.2019

Shoqëria: **Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize sh.p.k.**, me NUIS L8XXXXXX1A, me administrator z. Besar Gazidede dhe seli Rruga S. Delvina, Sheshi Wilson 1/1, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 69 40 50 005, Email: info@gazidede.al.

Drejtuar: **Degës së Doganës Tiranë**
Muçaj, Vorë
Tiranë, Shqipëri

Objekti: **Kthim përgjigje shkresës tuaj me nr. 999 prot. datë 08.10.2019.**

Baza ligjore:

- Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare" (në vijim referuar si "Ligji Për Taksat Kombëtare");
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 26 datë 04.09.2008 "Për Taksat Kombëtare" (në vijim referuar si "UMF Për Taksat Kombëtare");
- Ligji nr. 102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (referuar në vijim si "Kodi Doganor");
- VKM nr. 651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr. 102/2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (referuar në vijim si "Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor").

Të nderuar,

Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize sh.p.k. (referuar në vijim si "Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize" apo "Shoqëria"), regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë Tatimore Tiranë me NUIS L8XXXXXX1A, ka si objekt të aktivitetit konsulencën në fushën doganore dhe të akcizës.

Me datë 10.11.2019, me shkresën tuaj nr. 999 prot. datë 08.10.2019, Shoqëria u njoftua për t'u njohur me program kontrollin nr. 1001 prot. datë 01.10.2019.

Me datë 16.11.2019 jemi njohur me materialin e cituar në shkresën tuaj nr. 999 prot. datë 08.10.2019, ku identifikohet deklarata doganore e çlirimit për qarkullim të lirë me numër R 100 datë 01.01.2018, përmes së cilës Shoqëria ka importuar film ambalazhi vetëngjithës në role klasifikuar në kodin tarifor 3919 10 80 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Sqarojmë se artikulli film ambalazhi vetëngjithës në role që Shoqëria ka importuar klasifikohet saktësisht në kodin tarifor 3919 10 80 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, dhe as shkresa juaj dhe as përfundimet e program kontrollit nr. 1001 prot. datë 01.10.2019 nuk paraqesin ndonjë pretendim të ndryshëm.

Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize
Rruga Sulejman Delvina, Sheshi Wilson, 1/1, Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 69 405 0005, Email: info@gazidede.al, Web: https://gazidede.al
NUIS L82301001A



Gjithashtu sqarojmë se aplikimi i taksës së ambalazheve plastike (TAM) parashikohet nga Ligji Për Taksat Kombëtare dhe rregullohet përmes Udhëzimit të Ministrit të Financave Për Taksat Kombëtare, sipas versioneve në fuqi para datës 1 Janar 2019. Konkretisht:

1. Neni 4 Pika 8 Shkronja a) e Ligjit Për Taksat Kombëtare dhe Pika 2.8.1 e UMF Për Taksat Kombëtare përcaktojnë qartësisht se se taksa e ambalazheve të plastikës (TAM) aplikohet:
 - (i) për të gjithë ambalazhet prej plastike të Kreut 3923 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, në rastet kur importohen veçmas apo prodhohen në vend;
 - (ii) si dhe kur materiali plastik zë të paktën 51% të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera, për produkte që importohen apo prodhohen në vend.Baza ligjore e mësipërme përcakton se, në rastin e importit, taksa mblihet nga administrata doganore, ndërsa në rastin e prodhimit vendas taksa mblihet nga autoritetet tatimore.
2. Pika 2.8.5 e UMF Për Taksat Kombëtare përcakton se kur importohen produkte gjysmë të gatshme (pipeta plastike) të cilat klasifikohen në Kreun 3923 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, dhe të cilat janë qartësisht të destinuar për prodhimin e ambalazheve të plastikës, gjithashtu i nënshtrohen pagesës së TAM në momentin e importit.

Në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur, ambalazhet plastike **të importuara veçmas** janë subjekt i taksës së ambalazheve të plastikës (TAM) në momentin e importit vetëm nëse përmbushen njëkohësisht këto dy kushte: **(i)** bien nën përkufizimin e termit ambalazh sipas Nenit 3 Pika 8 të Ligjit për Taksat Kombëtare, dhe **(ii)** klasifikohen në Kreun 3923 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Artikulli i çliruar për qarkullim të lirë nga Shoqëria me deklaratën doganore R 100 datë 01.01.2018 me përshkrimin **film ambalazhi vetëngjithës në role** klasifikohen në kodin tarifor 3919 10 80 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, prandaj nuk është subjekt i taksës së ambalazheve plastike në momentin e importit sepse nuk klasifikohet në Kreun 3923 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Bazuar në sa më sipër dëshirojmë të theksojmë se jemi të gatshëm të paraqesim çdo sqarim që ju e konsideroni të nevojshëm lidhur me rastin.

Bashkëngjitur ju lutem gjeni:

1. Deklaratën doganore R 100 datë 01.01.2018;
2. [Vendosni dokumente të tjera të nevojshme për sqarimin e rastit]

Ju falënderojmë dhe ju urojmë punë të mbarë.

Me respekt,
Besar Gazidede
Administrator
Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize sh.p.k.
[Vula, firma]



Rreth Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize

Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize është emri tregtar i subjektit Besar Gazidede - Person Fizik, regjistruar me datë 1 Nëntor 2018 në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L82301001A, me adresë Rruga Sulejman Delvina, Sheshi Wilson, 1/1, Tiranë, Shqipëri.

Ne ofrojmë ekspertizë, këshillim dhe asistencë ligjore, procedurale dhe praktike:

- në fushën doganore;
- në fushën e akcizës në import dhe prodhimin vendas;
- në fusha të tjera që lidhen me lëvizjen ndërkombëtare të mallrave si TVSH, Taksat Kombëtare etj.

Shërbimet tona janë të dedikuara për importuesit, eksportuesit, prodhuesit, tregtarët, postën e shpejtë, transportuesit, agjensitë doganore, individët etj.

Ne reduktojmë kompleksitetin e legjislacionit dhe e vendosim atë në shërbim të interesit më të mirë të Klientëve tanë, me qëllim realizimin e objektivave si optimizimi i detyrimeve dhe taksave të pagueshme, optimizimi logjistik, kryerja e formaliteteve në mënyrë eficiente, pa pengesa dhe në kohë sa më të shkurtër.

Rreth Besar Gazidede



Besar Gazidede është ekspert doganor dhe akcize me eksperiencë pranë sektorit publik dhe privat. Është themelues i Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize me seli në Tiranë, Shqipëri ku ofron ekspertizë, këshillim dhe asistencë për kompanitë e përfshira në tregtinë ndërkombëtare të mallrave.

Eksperiencat e mëparshme të punës përfshijnë PricewaterhouseCoopers Albania and Kosovo si Konsulent Doganor & Akcize (2015-2018), Go Shipping Albania si Specialist për Import & Eksport (2014-2015), Drejtoria e Përgjithshme të Doganave si Specialist i Analizës së Riskut dhe Përgjegjës Sektori (2010-2014).

Besari është Diplomuar pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Dega Ekonomiks (2006-2010).

Keni nevojë të diskutoni me një ekspert lidhur me veprimtarinë doganore & akcizës të biznesit tuaj?

Jemi në dispozicion për t'ju asistuar.

Besar Gazidede
Konsulent Doganor & Akcize

Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize
Rruga Sulejman Delvina, Sheshi Wilson, 1/1, Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 69 405 0005, Email: info@gazidede.al, Web: <https://gazidede.al>
NUIS L82301001A



GAZIDEDE

CUSTOMS & EXCISE CONSULTING

Ky material është me karakter informues dhe shpreh kuptimin tonë lidhur me çështjet e trajtuara.

Ky material nuk përbën këshillë specifike profesionale.

Ne nuk mbajmë asgjë përgjegjësi lidhur me veprimet që ju apo palë të tjera ndërmerrni duke u bazuar mbi këtë material, pa marrë këshillë specifike profesionale.

© Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.